



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 296/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-22539-01-29-2016, Loti 1, me objekt “Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese, për vitin 2016”, me fond limit 20.134.046,9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”.

Ankimues:

“Ed Konstruksion” sh.p.k.
Rruga “Frederik Shiroka”, Nd.6, H.10, Ap.4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.01.2016, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-22539-01-29-2016, Loti 1, me objekt “Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese, për vitin 2016”, me fond limit 20.134.046,9 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 23.02.2016, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. “Ndregjoni” sh.p.k. | 15.484.477 lekë, kualifikuar |
| 2. “Alcon” sh.p.k. | 15.864.726,6 lekë, skualifikuar |
| 3. “4 AM” sh.p.k. | 16.068.122 lekë, skualifikuar |
| 4. “Hastoçi” sh.p.k. | 17.221.088 lekë, kualifikuar |
| 5. “Ed Konstruksion” sh.p.k. | 19.770.737,6 lekë, kualifikuar |
| 6. “Kevin Construction” sh.p.k. | 20.030.832,4 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 08.03.2016 operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 15.03.2016 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k.

1. “Ndregjoni” sh.p.k. nuk përmbush:

- Në DST pika ë) në lidhje me stafin, operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. ka të paisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT pjesë të kualifikuar të stafit të tij si inxhiniera, administratorin, ekonomist për profesione hidraulik, mirëmbajtës, elektrikist duke plotësuar kështu pjesërisht numrin e dëshmimeve të sigurimit teknik nga IQT [...]. Punonjësit me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT duke qenë me profesione reale të ndryshme nga ato të dëshmimeve të sigurimit teknik nga IQT nuk janë të pajisur me kontratë pune. Ky operator nuk e plotëson kriterin e vendosur në DST se ka në stafin e vet punonjës të kualifikuar me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT.
- Nuk plotëson kriterin ç) në lidhje me mjetet, pasi nuk disponon disa prej këtyre mjeteve[...]
- Pikën a) të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta për shërbimet e ngjashme[...], pasi ky operator ka punime civile fare të zakonshme, ndërkohë që objekti i kësaj procedure prokurimi është Loti 1 Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese për vitin 2016”. Për pasojë duke parë që natyra e kësaj kontrate është specifike ka punime elektrike, hidraulike dhe mirëmbajtje në ambjente spitalore si salla operacioni, ambjente ku ka rrezatime të ndryshme, laboratorë dhe ambjente të tjera me rëndësi të veçantë të cilat kërkojnë një përvojë pune specifike, në CV e këtij operatori nuk ka asnjë kontratë që e përmbush kriterin e shërbimeve spitalore të ngjashme.
- Nuk plotëson pikën 1 ç) të kriterëve të veçanta. Ky operator nuk ka vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka [...].

2. “Hastoçi” sh.p.k. nuk përmbush:

- Në DST pika ë) në lidhje me stafin, operatori ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. nuk e plotëson këtë kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor duke mos patur numrin e kërkuar në dokumentat e tenderit për punonjësit e pajisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT;
- Nuk plotëson kriterin ç) në lidhje me mjetet, pasi nuk disponon disa prej këtyre mjeteve[...]
- Pikën a) të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta për shërbimet e ngjashme[...], pasi ky operator ka punime civile fare të zakonshme, ndërkohë që objekti i kësaj procedure prokurimi është Loti 1 Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese. Për pasojë duke parë që natyra e kësaj kontrate është specifike ka punime elektrike, hidraulike dhe mirëmbajtje në ambjente spitalore si salla operacioni, ambjente ku ka rrezatime të ndryshme, laboratorë dhe ambjente të tjera me rëndësi të veçantë të cilat kërkojnë një përvojë pune specifike, në CV e këtij operatori nuk ka asnjë kontratë që e përmbush kriterin e shërbimeve spitalore të ngjashme.

II.5. Operatori ekonomik ankimes sqaron se në datën 19.03.2016, nëpërmjet shkresës nr. 1586/2 prot., datë 18.03.2016, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 24.03.2016 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k. tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Në datën 31.03.2016, nëpërmjet shkresës me nr.1828/1 prot., datë 30.03.2016, me objekt: “Kthim përgjigje Vendimit të KPP-së nr. 643/1 prot., datë 25.03.2016, prot në QSUT me nr. 1828, dt. 30.03.2016”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk plotëson kriterin në pikën e) në lidhje me stafin, pasi ka të paisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT pjesë të kualifikuar të stafit të tij si inxhiniera, administratorin, ekonomist për profesione hidraulik, mirëmbajtës, elektrikist duke plotësuar kështu pjesërisht numrin e dëshmimeve të sigurimit teknik nga IQT [...]. Punonjësit me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT duke qenë me profesione reale të ndryshme nga ato të dëshmimeve të sigurimit teknik nga IQT nuk janë të pajisur me kontratë pune, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Loti 1, Kapaciteti teknik, gërma “ë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar ose të kontraktuar në stafin e vet punonjësit e kualifikuar si më poshtë:

- të ketë jo më pak se 5 (pesë) punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit elektrik nga IQT me kategori IV dhe V
- të ketë jo më pak se 2 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit hidraulik nga IQT
- të ketë jo më pak se 1 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit saldator nga IQT
- të ketë jo më pak se 2 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit elektromekanik nga IQT
- të ketë jo më pak se 5 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT si punonjës mirëmbajtje.

Për stafin e punonjësve të kualifikuar, të paraqiten kontratat individuale të punës me operatorin ekonomik”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri rezulton se është paraqitur si më poshtë:

a) *Deklaratë mbi drejtuesin teknik të punimeve dhe punonjësit e kualifikuar ku rezulton:*

- [...] *Kam të punësuar punonjësit e kualifikuar si më poshtë:*

Dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit elektrik me kategori IV

1. *Xh.N. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV (TCPE)*

2. *S. S. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV (TCPE)*

3. *Q.N. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV (TCPE)*

4. *E.N. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV (TCPE)*

5. *A.LL. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV (IQT)*

Dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit hidraulik

1. *E.N. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

2. *S.Ç. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

Dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit saldator

1. *A.C. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

2. *Rr.K. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

Dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit Elektromekanik

1. *E. N. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

2. *A.N. dëshmi të sigurimit teknik (IQT)*

Dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit Mirëmbajtje

1. *L.P. dëshmi të sigurimit teknik TCPE*

2. *Y.N. dëshmi të sigurimit teknik TCPE*

3. *M.N. dëshmi të sigurimit teknik TCPE*

4. *M.N. dëshmi të sigurimit teknik TCPE*

5. *H.N. dëshmi të sigurimit teknik TCPE*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor duhet ta konsiderojë një ofertë të vlefshme, kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dëshmitë e kualifikimit të punonjësve të paraqitura nga operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. janë lëshuar disa nga IQT (Inspektoriat Qendror Teknik) dhe disa nga TCPE (trupë e çertifikuar) duke e përmbushur kriterin për sa i

përket dëshmime të kualifikimit, pasi edhe dëshmitë e paraqitura nga organe të tjera përveç IQT por që janë trupa çertifikuese do të konsiderohen të sakta përsa kohë që qëllimi i autoritetit kontraktor është të krijojë bindjen se një operator ekonomik ka staf të kualifikuar dhe të çertifikuar me dëshmitë përkatëse pavarësisht se nga cili organ janë lëshuar këto dëshmi kualifikimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k., në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur deklaratën për stafin, shoqëruar me dëshmitë e lëshuara nga Inspektoriat Qendror dhe nga trupa të tjera të çertifikuara (TPCE), por nuk janë paraqitur kontratat individuale të punës me operatorin ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e kontratave individuale të punonjësve të kualifikuar të lidhura me shoqërinë “Ndregjoni” sh.p.k. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. *se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk plotëson kriterin ç) në lidhje me mjetet, pasi nuk disponon disa prej këtyre mjeteve[...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, *Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Loti 1, Kapaciteti teknik, gërma “ç”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

- Matrapik dore (Kompresor)
 - Saldatriçe
 - Makinë teknologjike për pastrimin e ujrave të zeza
 - Skeleri dhe rrjetë mbajtëse 500m²
 - Autokullë vinç në lartësi jo më të vogël se 20 m. Koshi duhet të jetë i montuar në krahun e vinçit.
- Për të dëshmuar këtë, **Deklarata e disponueshmërisë së makinerive**, duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:*

- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten (Çertifikata e pronësisë , Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qirase ku afati i marjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të shërbimit, si dhe Çertifikata e pronësisë , Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk rregjistrohen në rregjistrat publik duhet të paraqiten fatura tatimore blerje”.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri rezulton se është paraqitur Shtojca 9 “Mbi disponimin e makinerive” ku deklarohen mjetet në pronësi: matrapik dore (kompresor), saldatriçe, makinë teknologjike për pastrimin e ujrave të zeza, skeleri dhe rrjetë mbajtëse 500 m², gurë fleksibël dhe me qera: Autokullë vinc në lartësi jo më të vogël se 20 m. Gjithashtu është paraqitur ndërmjet të tjerave dokumentacioni provues si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje nr. 6, datë 30.03.2012, për mjetin elektrogur;
- Kontratë qeraje e lidhur në datën 23.10.2015, për një afat 5 vjeçar, ndërmjet shoqërisë qeramarrëse “Ndregjoni” sh.p.k. dhe shoqërisë qeradhënëse “Bajrami” sh.p.k. për mjetet: Kamion (APV), targa AA 206 HB[...]; asfaltoshtruese kimatsu[...]; asfaltoshtruese sipas faturës datë 27.09.2001; bitumatriçe sipas faturës datë 20.05.2003[...]; rrul vibruës sipas deklaratës së zhdoganimit [...]; grejder tip MBU G4 sipas deklaratës së zhdoganimit datë 23.03.2005; kompresor ajri sipas deklaratës së zhdoganimit datë 03.12.2005; autobetonjere stacionere sipas deklaratës së zhdoganimit bashkëngjitur; minieskavator sipas deklaratës së zhdoganimit[...]; fadromë sipas deklaratës së zhdoganimit bashkëngjitur; kamion saurer; paisje për shpërndarjen e kripës [...]; kamion borëpastrues[...];
- Leje qarkullimi për mjetin me targë AA206HB; policë për sigurimin e detyrueshëm; çertifikatë e kontrollit teknik; licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendi;
- Fletë zhdoganimi për automjet me platformë ngritëse ;
- Faturë tatimore shitje nr. 443, datë 7.06.2003 për dërrasë e zdrugar; skeleri hekur; dizarment;
- Faturë tatimore shitje nr. 36, datë 29.06.2003 për skela; vida metalike;
- Faturë tatimore shitje nr. 35, datë 29.06.2003 për skela; vida metalike;
- Faturë tatimore shitje nr. 475, datë 13.05.2003 për profile;
- Faturë tatimore shitje nr. 150, datë 30.06.2003 për panela druri;
- Faturë tatimore shitje nr. 130, datë 25.07.2003 për skela metalike; dërrasë e çarrë;
- Faturë tatimore shitje nr. 09.09.2003 për betoniere; skela ndërtimi;
- Faturë tatimore shitje nr. 823, datë 15.09.2003 për skelë lidhëse[...];
- Faturë tatimore shitje nr. 182, datë 28.09.2003 për skela metalike;
- Faturë tatimore shitje nr. 196, datë 24.10.2003 për betoform; dru i sharruar;
- Faturë tatimore shitje nr. 17, datë 20.01.2007 për skel armaturë; puntel;
- Faturë tatimore shitje nr. 29, datë 5.02.2007 për skel armaturë [...];

- Faturë tatimore shitje nr. 73, datë 17.05.2004 për skela ndërtim;
- Faturë tatimore shitje nr. 26, datë 27.02.2004 për skela metalike; dru i sharruar;
- Faturë tatimore shitje nr. 72/2, datë 3.11.2008 për panel druri; profile të aluminit; bango;
- Faturë tatimore shitje nr. 74/2, datë 5.11.2008 për panele (bango);
- Faturë tatimore shitje nr. 2738, datë 21.11.2008 për bango;
- Faturë tatimore shitje nr. 164, datë 02.05.2007 për transformator; panele fibre;
- Faturë tatimore shitje nr. 828, datë 27.02.2007 për polisterol;
- Faturë zhdoganimi për panele [...]
- Faturë tatimore shitje nr. 1, datë 04.01.2007 për panele MDF;
- Faturë tatimore shitje nr. 27, datë 22.07.2005 për lëndë druri[...];
- Faturë tatimore shitje nr. 182, datë 29.07.2005 për panele fibre;
- Faturë tatimore shitje nr. 250, datë 29.7.2005 për dërrasë druri; skela hekuri;
- Faturë tatimore shitje nr. 2387, datë 30.11.2015 për rrjeta;
- Faturë tatimore shitje nr. 555, datë 14.11.2015 për rrjetë tapa; tel [...];
- Faturë tatimore shitje nr. 2620, datë 16.12.2011 për bot teknologjik 5000 lt;
- Fletë zhdoganimi për makinë saldimi me elektrofuzion;
- Faturë tatimore shitje nr. 13, datë 04.06.2014 për helikopter për rrafshim bet., ngjeshës kostipator, saldatrice, stampa betoni;
- Faturë tatimore shitje nr. 549, datë 02.08.2011 për matrapik, punto betoni, punto betoni[...]

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor duhet ta konsiderojë një ofertë të vlefshme, kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.5. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht në lidhje me mjetin *makineri teknologjike për pastrimin e ujërave të zeza*, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin *faturë tatimore shitje nr. 2620, datë 16.12.2011 për bot teknologjik 5000 lt*, duke mos u përmbushur kërkesa e autoritetit kontraktor për makineritë që ka në dispozicion, pasi boti teknologjik nuk përfshin në tërësinë e tij elementët që ka makineria teknologjike për pastrimin e ujërave të zeza si edhe më kryesorja nuk mund të kryejë të gjitha ato funksione që kryen kjo makineri.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për dorëzimin e mjetit makineri teknologjike për pastrimin e ujërave të zeza. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori ekonomik, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. se operatori ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. nuk plotëson kriterin në pikën e) në lidhje me stafin, duke mos patur numrin e kërkuar në dokumentat e tenderit për punonjësit e pajisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Loti 1, Kapaciteti teknik, gërma “e”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar ose të kontraktuar në stafin e vet punonjësit e kualifikuar si më poshtë:

- të ketë jo më pak se 5 (pesë) punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit elektrik nga IQT me kategori IV dhe V
- të ketë jo më pak se 2 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit hidraulik nga IQT
- të ketë jo më pak se 1 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit saldator nga IQT
- të ketë jo më pak se 2 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik për punonjësit elektromekanik nga IQT
- të ketë jo më pak se 5 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT si punonjës mirëmbajtje.

Për stafin e punonjësve të kualifikuar, të paraqiten kontratat individuale të punës me operatorin ekonomik”.

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri rezulton se është paraqitur si më poshtë:

1. A. V dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV elektrikist (HTM) dhe kontratë pune
2. M.GJ. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV elektrikist (HTM) dhe kontratë pune
3. H.Gj. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV elektrikist (HTM) dhe kontratë pune
4. V.V. dëshmi të sigurimit teknik me kategori IV elektrikist (HTM) dhe kontratë pune
5. SH.K. dëshmi të sigurimit teknik hidraulik (HTM) dhe kontratë pune
6. A.Gj. hidraulik, kontratë pune dhe librezë pune
7. Z.K. dëshmi të sigurimit teknik saldator (HTM) dhe kontratë pune
8. M.H. dëshmi të sigurimit teknik elektromekanik (IQT) dhe kontratë pune
9. M.K. dëshmi të sigurimit teknik elektromekanik (IQT) dhe kontratë pune
10. N.B. dëshmi të sigurimit teknik mirëmbajtës (HTM) dhe kontratë pune
11. M.H. dëshmi të sigurimit teknik mirëmbajtës (HTM) dhe kontratë pune
12. V.N. dëshmi të sigurimit teknik punëtor (HTM) dhe kontratë pune
13. D.A. dëshmi të sigurimit teknik mirëmbajtës (HTM) dhe kontratë pune
14. Y.V. dëshmi të sigurimit teknik mirëmbajtës (HTM) dhe kontratë pune
15. B.C. dëshmi të sigurimit teknik elektrovinçier (HTM) dhe kontratë pune

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor duhet ta konsiderojë një ofertë të vlefshme, kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.4.5. Konstatohet se operatori ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. ka paraqitur për punonjësit e deklaruar dëshmitë e kualifikimit teknik të lëshuara disa nga IQT (Inspektoriati Qendror Teknik) dhe disa nga HTM (trupë e çertifikuar) duke e përmbushur kriterin përta i përket dëshmitë të kualifikimit, pasi edhe dëshmitë e paraqitura nga organe të tjera përveç IQT por që janë trupa çertifikuese do të konsiderohen të sakta përta kohë që qëllimi i autoritetit kontraktor është të krijojë bindjen se një operator ekonomik ka staf të kualifikuar dhe të çertifikuar me dëshmitë përkatëse pavarësisht se nga cili organ janë paraqitur këto dëshmi kualifikimi si edhe kontratat e punës individuale të lidhura ndërmjet secilit punonjës të deklaruar dhe shoqërisë “Hastoçi” sh.p.k., por ka mangësi në dokumentacion përta i përket numrit referuar kriterit në dokumentat e tenderit.

Konkretisht nga shqyrtimi konstatohet se operatori ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me numrin e kërkuar dhe të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe ka mangësi përta i përket punonjësve si hidraulik,

mirëmbajtës, duke mos përmbushur kështu kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor që në publikimin e kësaj procedure prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me stafin për punonjësit e kualifikuar sipas kategorive përkatëse. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. *se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. nuk plotëson kriterin ç) në lidhje me mjetet, pasi nuk disponon disa prej këtyre mjeteve[...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, *Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Loti 1, Kapaciteti teknik, gërma “ç”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

- Matrapik dore (Kompresor)
 - Saldatriçe
 - Makinë teknologjike për pastrimin e ujrave të zeza
 - Skeleri dhe rrjetë mbajtëse 500m²
 - Autokullë vinç në lartësi jo më të vogël se 20 m. Koshi duhet të jetë i montuar në krahun e vinçit.
- Për të dëshmuar këtë, **Deklarata e disponueshmërisë së makinerive**, duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:*

- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten (Çertifikata e pronësisë, Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qirase ku afati i marjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të shërbimit, si dhe Çertifikata e pronësisë, Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk rregjistrohen në rregjistrat publik duhet të paraqiten fatura tatimore blerje”.*

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të operatorit ekonomik “Hastoçi” sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri rezulton se është paraqitur Shtojca 9 “Mbi disponimin e makinerive” ku deklarohen mjetet në pronësi: kamioncinë, matrapik dore (4 copë), kompresor, kompresor + vegla pune, gjenerator + motosaldatriçe, motosaldatriçe, skeleri 3000 m² rrjetë mbrojtje, dhe me qera: mjet për pastrimin e ujrave të zeza, autokullë vinc në lartësi jo më të vogël se 20 m. Gjithashtu është paraqitur ndërmjet të tjerave dokumentacioni provues si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje nr. 1395, datë 21.12.2006, për gjenerator, gurë abraziv, trapan dore, saldatrice etj.;
- Faturë tatimore shitje nr. 1302, datë 20.06.2013, për rrjetë plastike;
- Faturë tatimore shitje nr. 149, datë 19.06.2010, për skeleri;
- Leje qarkullimi për mjetin me targë TR3573I; policë për sigurimin e detyrueshëm; çertifikatë e kontrollit teknik; çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet;
- Faturë tatimore shitje nr. 15, datë 06.03.2015, për kompresor;
- Faturë tatimore shitje nr. 1773, datë 02.10.2007, për kompresor, shkallë, pompë uji, gurë abraziv, punto, [...] trapan, [...];
- Kontratë qeraje e lidhur në datën 20.02.2016, për një afat 1 vjeçar, ndërmjet shoqërisë qeramarrëse “Hastoçi” sh.p.k. dhe shoqërisë qeradhënëse “Pastrime Silvio” sh.p.k. për mjetin Autokullë vinc me kosh – me lartësi mbi 20 m, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm, certifikatë pronësie;
- Kontratë qeraje e lidhur në datën 20.02.2016, për një afat 1 vjeçar, ndërmjet shoqërisë qeramarrëse “Hastoçi” sh.p.k. dhe “Astrit Harizaj” për mjetin Autobot për pastrimin e ujrave të zeza, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm, certifikatë pronësie, certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet;
- Faturë tatimore shitje nr. 725, datë 16.06.2012, për matrapik me daltë;
- Faturë tatimore shitje nr. 424, datë 21.08.2015, për sharrë metalprerëse, saldatrice.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në lidhje me mjetin autobot për pastrimin e ujrave të zeza, dokumenti çertifikatë për transport mallrash brenda vendit është për llogari të vet, në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi kur mjete jepet me qera. Sqarojmë se në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]”

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik

3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;

b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;

c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;

d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;

e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;

f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

....

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]"

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", parashikohet se : "[...]"

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]"

Në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", parashikohet se : "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse."

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se *lex specialis*, Ligji "Për Transportet Rrugore" bën qartësisht ndarjen midis licencës lëshuar Transport për vete përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi, si edhe licencës lëshuar për Transport për të tretë dhe me qira përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se licenca të cilën disponon personi fizik A.I. është specifike dhe e lëshuar vetëm për Transport për vete përmes së cilës është i licencuar vetëm ky person për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë "Hastoci" sh.p.k. me kamionët e personit fizik A.I. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit "Për Transportet Rrugore" është i ndaluar. Mungesa e licencës së mësipërme, vërtëton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi, por përdorimi i saj do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Hastoçi” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori ekonomik, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-22539-01-29-2016, Loti 1, me objekt “Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese, për vitin 2016”, me fond limit 20.134.046,9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 643 Protokolli

Datë 24.03.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri

Mendim Kunder

Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Juliana Hoxha shpreh mendimin tim kunder ne lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimes, potencialisht fitues i kontratës, për sa i përket ankeses me objekt: “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-22539-01-29-2016, Loti 1, me objekt “*Riparim – mirëmbajtje ndërtimore e objekteve ekzistuese, për vitin 2016*”, me fond limit 20.134.046,9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”.

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I. Bazuar në nenin 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, *citoj.....*” *Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve*”, gjithashtu në nenin 46, pika 1, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

I.1 Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike (*shih nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar*), është garant i kontrollit të ligjëshmerisë si nga ana institucioneve dhe enteve publike/private që realizojnë procedurat e prokurimit publik dhe i nenshtrohen rregullave të prokurimit publik, ashtu edhe të operatorëve ekonomik (shoqërive tregëtare) pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, duke mbajtur në konsideratë nenin 64 pika 3 e ligjit të sipërcituar, në të cilin shprehen kompetencat e KPP, citoj “*.....Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.*

Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

I.1.1. Referuar sa më sipër, konstatoj se nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se në këtë procedurë prokurimi janë kualifikuar vetëm tre operatorë ekonomikë dhe janë skualifikuar të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës.

Konkretisht janë kualifikuar operatorët ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k., “Hastoçi” sh.p.k. dhe “Ed Konstruksion” sh.p.k. Në kushtet kur pas shqyrtimit të ankesës në KPP mbetet i kualifikuar vetëm operatori ekonomik ankimues (Ed Konstruksion sh.p.k.), duke marrë në konsideratë kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik para lidhjes së kontratës, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si edhe në respekt të parimit të barazisë, transparencës dhe mos diskriminimit, si tre ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik e njëherazi referuar edhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Ed Konstruksion” sh.p.k. gjykoj të shqyrtohet edhe dokumentacioni i operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k.

I.1.2. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për operatorët ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k., u verifikua dokumentacioni i operatorit ekonomik ankimues i cili pas shqyrtimit të ankesës pranë KPP ngelet potencialisht fitues i kontratës, dhe konkretisht dokumentacioni në lidhje me mjetet nga shqyrtimi i të cilit (dokumentacionit për të cilin ankimuesi ka ngritur pretendime për operatorët ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k. dhe “Hastoçi” sh.p.k.), nga ku rezulton se:

I.1.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, *Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes*, Loti 1, *Kapaciteti teknik*, gërma “ç”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*”

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

- *Matrapik dore (Kompresor)*
- *Saldatriçe*
- *Makinë teknologjike për pastrimin e ujrave të zeza*
- *Skeleri dhe rrjetë mbajtëse 500m²*
- *Autokullë vinç në lartësi jo më të vogël se 20 m. Koshi duhet të jetë i montuar në krahun e vinçit.*

*Për të dëshmuar këtë, **Deklarata e disponueshmërisë së makinerive**, duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:*

- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten (Çertifikata e pronësisë, Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që rregjistrohen në rregjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qirase ku afati i marjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të shërbimit, si dhe Çertifikata e pronësisë, Leje qarkullimi, Polica e Sigurimit, Kontrolli Teknik Vjetor, çertifikatën e transportit nga Komuna apo Bashkia të vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk rregjistrohen në rregjistrat publik duhet të paraqiten fatura tatimore blerje”.*

I.1.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. në përmbushje të këtij kriteri rezulton se në përmbushje të kriterit për makinë teknologjike është paraqitur dokumentacioni:

- Kontratë qeraje automjeti e lidhur në datën 22.02.2016, për një afat 1 vjeçar, ndërmjet shoqërisë qeramarrëse “Ed Konstruksion” sh.p.k. dhe shoqërisë qeradhënëse “Fusha” sh.p.k. për mjetin APV (makine teknologjike për pastrimin e ujrave të zeza), shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm, taksat vjetore;

I.1.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

I.1.2.4. Konstatohet se në lidhje me mjetin teknologjik operatori ekonomik ankimes nuk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit pasi i mungon certifikata e transportit nga Komuna apo Bashkia e vlefshme.

Gjykoj se në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjykoj se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me paraqitjen e dokumentacionit për mjetet.

I.1.2.5. Përfundimisht gjykoj se, autoriteti kontraktor nuk ka vlerësuar objektivisht konform legjislacionit të prokurimit publik si dhe kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duke vlerësuar se asnjë nga ofertat ekonomike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kushtet për të qënë potencialisht fitues i kontratës objekt prokurimi.

I.1.2.6. Vlerësoj se Komisioni i Prokurimit Publik duhet të jetë garant i kontrollit të ligjshmërisë dhe vlerësimit objektiv të ofertave nga ana e autoriteteve kontraktore (institucioneve dhe enteve publike që realizojnë procedurat e prokurimit) duke shmangur vlerësimet subjektive dhe jo të lidhura me dokumentacionin e depozituar nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokuruese.

Anëtare
Juliana Hoxha

